



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova  
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI  
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT  
NR. 12/2018**

19 dhjetor 2018

## I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, si në vijim:

### PROJEKT -RREGULLORE (AAC) NR. xx /2018 PËR GJOBAT ADMINISTRATIVE TË SHQIPTUARA NGA AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I KOSOVËS.

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, pika 5.2 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, përkatësisht nga data 28 tetor deri me 05 dhjetor 2018.

Neni 5, Pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që: “AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht ; dhe/ose

b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuar”

Në pamundësi të organizimit të takimeve publike me palët e interesuara, konsultimi publik u realizua sipas pikës 5.1, a) të udhëzimit të lartëcekur.

## II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes së dërguar për konsultim publik të palëve të interesit i janë përgjigjur katër palë të interesit të cilët kanë paraqitur vërejtjet/sugjerimet e tyre nëpërmes postës elektronike zyrtare të AAC-së. Në vijim janë të pasqyruara vërejtjet/sugjerimet e pranuar në formë origjinale siç janë dërguar dhe pranuar në AAC për projekt-rregulloren e lartpërmendur, ndërsa në formë të përmbledhur janë paraqitur vërejtjet/përgjigjet e AAC-së, si dhe ndërhyrjet në tekst të projekt-rregullores, aty ku është konsideruar relevante. Rradhitja e shqyrtimit të komenteve/sugjerimeve është bërë në bazë të radhitjes kalendarike të pranimit të komenteve dhe/ose sugjerimeve nga palët, nëpërmes adresës elektronike.

### I. Dërguar nga Gökmen ARITAY, LIMAK Kosovo International Airport më dt. 01.12.2018

#### 1. General Comments;

- KFOR; has no legal right over the commercial enterprises This is against the law and our Concession Agreement with Government of Kosovo.
- CAAK's administrative fine regulation shall be related with the CAAK activities only in the scope of CAAK, there are some conflicts between draft regulation and the other signed agreements of RKS, such as PPP agreement.
- It's not stated that the fines for how long or for any period?

#### 1. *Dy komentet e para të përgjithshme janë të adresuara në mënyrë specifike më poshtë. Rreth komentit të tretë të përgjithshëm ju lutem referojuni nenin 15 të Projekt Rregullores për gjobat administrative të shqiptuara nga AACK.*

2. Article 5  
Clause 5.1. CAAK shall be able to initiate this procedure only for the cases that which will be in the scope of CAAK duties. In addition to that, there is no clear state that Police and KFOR (see also General Comments) will inform to CAAK for which cases via using which legal rights?
2. *Nuk Pranohet*  
*Neni 1 dhe 2 i Rregullores (AAC) nr. xx /2018 për gjokat administrative të shqiptuara nga AACK e tregon qartë qëllimin dhe fushëveprimin e kësaj rregulloreje.*
3. Clause 5.3 states that CAAK may use any information; does it cover the media? We believe that it shall be an information which has a clear legal basis and proof. In addition to that, based on EU Data Protection Regulation, neither CAA nor any other agency or legal person has no right to share any personal data which has collected and shared with them with a purpose of statistical data by Airport Operator, with 3rd parties or media.
3. *Nuk Pranohet*  
*AAC mund të përdorë informata të verifikuara nga çdo burim apo institucion sipas procedurave.*
4. Article 6  
CAAK shall prove the expertise and legal authority (training, certificates, experience etc.) of the member of committee.
4. *Nuk Pranohet*  
*Janë kompetenca të cilat përcaktohen me Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (më tej "LAC").*
5. Article 7  
Clause 7.2.1. It's against to the law, not matter public interest of urgency, as long as there would be a fine so 3rd party shall be informed in advance. Any party shall have a right to use legal objection to any fine in court platform based on law
5. *Nuk pranohet.*  
*Përrjashtime nga e drejta e të dëgjuarit të palës në raste urgjente për shkak të një interesi publik, që mund t'i shkaktohet një dëm nga vonesa, është në përputhje me rregullimin që ja bën kësaj çështjeje Ligji për procedurën e përgjithshme administrative.*
6. Article 9  
Not limited with clause 9.5, all article has no basis and addressing to the possibility of interpretation by the "Committee" For instance, fines shall not base on "capability" for each person or legal entity for the same cases!
6. *Nuk pranohet.*  
*Kjo e drejtw derivon nga neni 98 paragrafi 1 i LAC .*
7. Article 10  
The scope of this regulation shall be limited with the authorities of CAAK, text "but are not limited to" shall be removed and "civil aviation" shall be changed since the only authority of civil aviation activities is not CAAK (MIA for Aviation Security, CAD of MI for Flight Permi and Passenger Rights)

7. *Nuk Pranohet.*  
*Neni 1 dhe 2 i rregullores (AAC) nr. xx /2018 për gjobat administrative të shqiptuara nga AACK e tregon qartë qëllimin dhe fushëveprimin e kësaj rregulloreje.*
8. Article 12  
Every administrative decision is eligible to re-evaluate in the Courts by law and EU regulation as well so this article is completely conflict to the laws.
8. *Neni 12 paragrafi 3 i Rregullores në fjalë e përcakton që për çdo vendim të drejtorit të përgjithshëm në lidhje me shqiptimin e gjobave administrative mund të inicohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente administrative të Republikës së Kosovës.*
9. Table 1 Interferences  
General Comments  
Interval between minimum and maximum fines are too big and very open to interpretation (for instance 200-15.000)
9. *Nuk pranohet.*  
*Shumat e gjobave janë brenda vlerave të përcaktuara në nenin 96 të LAC.*
10. Clause 2.  
The statement shall be fixed as below  
Fails to act upon the decision or directive granted by the CAA which must be in written form and only for “recommendations”
10. *Nuk pranohet*  
*Operatori duhet të veprojë sipas secilit vendim apo direktivë të dhënë nga AAC-ja.*
11. Clause 4.1.  
We propose the text like that; If, at the request of the CAA they do not enable the performance of safety oversight tasks and if they do not deliver requested data and documentation without delay unless the data/documentation is under protection of commercial contracts or other international/national regulation or data protection regulation of EU.
11. *Nuk Pranohet.*  
*Ky nen është në përputhje me nenin 21.5 të LAC.*
12. Clause 4.2.  
We propose the text like below;  
if in any way they prevent the inspector from the performance of inspection in accordance with the Law on Civil Aviation, regulations passed on the basis of the Law on Civil Aviation and other regulations international obligations, as well as with the relevant EU regulations.
12. *Nuk pranohet*  
*Pika 4.2 nuk ka të bëjë me këtë çështje.*
13. Clause 4  
We propose the text as below;  
  
Offences committed by aircraft operators or owners, airport operators or other legal entities, persons responsible and other natural persons

Aircraft owner or operator, pilot-in-command, airport operator and competent health service institutions and agencies of RKS who is responsible to act on Emergency condition based on Emergency Plan. Exercise and real Emergency shall have different fines shall be fined in the amount from EUR 4000 to 150,000 for the offence, if on request of the Appropriate Authority competent for search and rescue do not participate in the search and rescue procedure or if they do not provide resources required for search and rescue, if they do not provide emergency medical aid, or do not take measures for the transport of survivors. The offences to not participate to the Airport Emergency exercise which has ruled by the regulation of CAAK shall also be fined.

13. *Nuk pranohet*  
*Nënkuptohet qe bëhet fjalë për RKS.*
14. Table 2  
Clause 8  
Statement needs to change to  
“Offences in cases of not complying with CAA legislation, standards, rules, procedures, orders and directives”
14. *Është propozimi i njëjtë siç është i formuluar në rregullore.*
15. In clause 8.1, the written amount in text and in the column, are different (3.000-15.000/2.500-150.000)
15. *Pranohet*  
*Do të rregullohen shumat.*
16. Clause 9  
We propose some corrections/additional text as below for each clause, there are also some point that needs to be clarified by your authority;  
9.2 Permits the use of an aerodrome without valid certificate or approval or without registration in the Aerodromes Register of the Republic of Kosovo or if, at the time of operations, the aerodrome does not comply with the standards required for safe and secure conduct of air transport.  
The authority who gives a “permit” is CAAK so we couldn’t understand who will permit to use aerodrome without certificate?
16. *Pranohet.*  
*Pika 9.2 riformulohet si në vijim:*  
*“Aerodrome operator allows the use of an aerodrome without valid certificate or approval or without registration in the Aerodromes Register of the Republic of Kosovo or if, at the time of operations, the aerodrome does not comply with the standards required for safe and secure conduct of air transport.”*
17. 9.3 Fails to ensure that the aerodrome is operational during its declared operating hours in AIP and/or NOTAM
17. *Pranohet.*  
*Pika 9.3 riformulohet si në vijim:*

*“Fails to ensure that the aerodrome is operational during its declared operating hours based on the terms of the aerodrome certificate.”*

18. 9.4 Fails to ensure for use an aerodrome infrastructure, at the aerodrome for public use, to an aircraft permitted to operate within the Kosovo airspace.

It's against to Civil Aviation Law, as an airport operator, we have right to refuse to serve in case of commercial or operational issue of the air carrier for Airport Operator

18. *Nuk pranohet.*

*Pika 9.4 nuk e përjashton te drejtën e operatorit të garantuar me LAC.*

19. 9.9 Fails to provide prescribed rescue and firefighting services and emergency medical service (aerodrome services), in accordance with the CAA regulation. It needs a closure of airport, not an administrative fine

19. *Nuk Pranohet*

*Bëhet fjale kur aeroporti është i hapur për operime dhe dështon te ofroje shërbime.*

20. 9.10 The maneuvering areas, aprons, buildings, installations, facilities and equipment of an aerodrome are not maintained and supervised according to the procedure prescribed by the CAA and the competent air traffic control unit is not notified on their state.

There is no regulation of CAAK for many of those maintenance (such as equipment, facilities, installations, buildings) other standards are international. In addition to that, “competent Airport Operator is not notified on their state” shall be also added into the clause.

20. *Pranohet.*

*Pika 9.10 riformulohet si në vijim:*

*“The maneuvering areas, aprons, buildings, installations, facilities and equipment of an aerodrome are not maintained and supervised based on the terms of the aerodrome certificate/approval and the competent air traffic control unit is not notified on their state.”*

21. 9.11 does not use the runways, taxiways and other tracks, apron, buildings, installations, facilities or equipment according to their purposes and capacities and in accordance with the provisions of the regulations in force and if does not ensure to an aircraft permitted to operate within the Kosovo airspace usage of aerodrome buildings and infrastructure.

We need a clarification for this clause, not clearly stated

21. *Pranohet. Pika 9.11 riformulohet si në vijim*

*“Runways, taxiways, aprons, buildings, installations, facilities or equipment are not used by aerodrome operator in accordance with the terms of the aerodrome certificate/approval and in accordance with the provisions of the regulations in force. Aerodrome operator does not ensure usage of aerodrome infrastructure to an aircraft with the valid permit to operate within the Kosovo airspace.”*

22. 9.12 Does not use systems, devices, equipment and facilities according to the technical documentation, user manuals and maintenance programs or if such technical documentation, user manuals and maintenance programs are not properly kept and updated, If this situation creates a safety issue. Otherwise it won't be in the scope of CAAK.

22. *Nuk Pranohet*

*Është e vetëkuptueshme që behet fjalë për çështje të sigurisë.*

23. 9.13 Fails to ensure monitoring and assessment of the wildlife hazards on the aerodrome and its' surrounding and fails to establish means and procedures to minimise the risk of collisions between wildlife and aircraft.

“It's surrounding” is not clear prescription.

23. *Nuk pranohet*

*Sqarimet janë të dhëna në TP 20.*

24. 9.14 Fails to monitor and identify obstacles within established aerodrome's obstacle limitation and protection surfaces or fails to mark and light the obstacles which might affect safety so as to be visible by day, by night, and in low visibility conditions.

“Failing to monitor” is very subjective perspective, can be easily missed unintentionally. This clause shall be changed to “ not take measures and not informing to CAAK if the obstacle clearly exist and be able to monitor”

24. *Pranohet.*

*Pika 9.14 rihormulohet si në vijim*

*“Fails to establish effective monitoring system for identification and monitoring of obstacles within established aerodrome's obstacle limitation and protection surfaces or fails to mark and light the obstacles, in accordance with the regulations in force.”*

25. 9.20 They conduct training of aviation personnel and other qualified personnel contrary to the approved training programs or if they conduct training and do not meet the prescribed requirements for conducting training of aviation personnel and other qualified personnel. The clause shall include “ based on published regulation of CAAK”

25. *Pranohet.*

*Pika 9.20 riformulohet si në vijim.*

*“Training of aviation personnel and other qualified personnel is not provided based on the approved training program or training is provided without valid approval for the training subject or training instructor.”*

26. 9.22 Fails to ensure that, in the course of the use of an aerodrome, the environmental protection measures are applied, in accordance with this Law and the regulations governing environmental protection.

This is not CAAK issue, this is the scope of Ministry of Environment. CAAK should apply to related Ministry if CAAK notice something.

26. *Pranohet.*

*Fshihet pika 9.22*

27. 10.2 The aviation personnel and other qualified personnel perform their duties negligently, without quality, disorderly and contrary to the regulations in force in the Republic of Kosovo.

This clause is open to interpretation and there is no specific explanation and no measurable except “regulation in force” part.

27. *Nuk pranohet.*

28. 11. A fine shall be imposed to the operator or owner of the aircraft, the commander of the aircraft, the aerodrome operator and other competent health institution if they don't participate in the search and rescue procedure at the request of the state agency responsible for the protection and rescue or, if they make available their resources for search and rescue or if they do not provide urgent medical assistance or take measures to transport the survivors. It shall include the Government Agencies who must participate the Emergency (including exercise) based on Airport Emergency Plan.

28. *Nuk pranohet.*

*AAC nuk lëshon gjoba për institucionet tjera shtetërore.*

29. 19 Airport operators

19.1 Do not respect the basic principles of tariff setting or establish a new, amended or modulated fee without the approval of CAA.

This clause shall be only for the fees that CAAK is responsible to regulate.

29. *Nuk pranohet.*

*Të lutem referojuni nenit 1 Rregullores (AAC) nr. xx /2018 për gjobat administrative të shqiptuara nga AACK*

30. 21.1 Do not submit audited financial statements for the previous financial year.

We are not obliged to submit our financial statements to the CAAK since we are submitting to the Ministry of Finance, PPP Unit. This clause should be deleted or changed.

30. *Ju lutem referojuni Neni 14 i Rregullores së AAC-sw nr. 3/2015 mbi Tarifat e aeroportit dhe neni 4 i Rregullores së AAC-sw nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë. Për informim pasqyrat financiare të audituara të LIMAK janë dorëzuar rregullisht në AAC që nga fillimi i operimit tuaj në Kosovë.*

## II. **Dërguar nga Artan Hasani, Kryetar SINKON, dt. 04.12.2018**

31. Gjeja e pare qe na ka terhequr vemendjen eshte gjoba per personat fizik dhe pergjegjes, ne vecanti neni 18 i shtojces dhe mekanizmat per shqiptimin e ketyre gjobave. Te i zberthejme keto dyjat veq e veq.

1. Gjobat per persona fizik – sic e kemi kuptuar, ju parashihni gjoba edhe per personat fizik ne te ardhmen dmth edhe per KTA-te ne vecanti. Ne kemi kontaktuar ATCEUC dhe IFATCA si dhe shtetet evropiane ne vecanti, per kete ceshtje per t'i pyetur se si e rregullojne keto shtete kete gje. Pergjigja e seciles sindikate ka qene qe AAC nuk shqipton gjoba fare per KTA dhe nje ose dy pergjigje kane qene qe AAC ka nje rregullore te tille ne shtetin e tyre por ajo nuk i shqipton gjobat por gjyqi eshte organ per shqiptim te gjobave dhe ate vetem per raste te ndonje neglizhence madhore. Inicimin per kete gje e ben OSHNA dhe jo AAC. Arsyeya eshte shume e thjeshte, pasi qe kjo praktike e tille nese tenton te instalohet bie ndesh me "Just Culture Policy". Me kete gje AAC mund te kontribuoj ne uljen e numrit te raportimeve nga KTA-te (Occurence report) poashtu edhe nga personeli tjetër i OSHNA-s dhe me kete ne uljen e sigurise ne aviacion.

31. *Neni 4 i draft rregullores përcakton që "Procedura për shqyrtimin e shkeljeve administrative nga AAC fillojnë pasi që janë bërë përpjekje paraprake që në mënyrë të arsyeshme të*



*respektohen mekanizmat në kuadër të procesit të zbatimit të rregullave dhe rregulloreve të përcaktuara me procedurat përkatëse të AAC-së.” Rrjedhimisht, gjordat do të vendosen vetëm në rast të shkeljes së qëllimshme, të vazhdueshme ose neglizhencës serioze, dhe nuk bie ndesh me “just culture”.*

*Për më shumë, mos raportimi i ndodhive (Occurrence report) bien ndesh me “Just Culture” dhe është e dënueshme sipas pikës 9.16 të kësaj draft rregulloreje.*

32. 2. Gjordat për persona përgjegjës – ndoshta neve si sindikate nuk na takon edhe me koment të kete pjese, por ne shohim shume telashe ne te ardhmen, ne menagjim, nese aplikohet kjo dispozite e rregullores. Mu per kete edhe jemi kunder ndeshkimeve te personave përgjegjës nga AAC.

32. *Neni 4 i draft rregullores përcakton që “Procedura për shqyrtimin e shkeljeve administrative nga AAC fillojnë pasi që janë bërë përpjekje paraprake që në mënyrë të arsyeshme të respektohen mekanizmat në kuadër të procesit të zbatimit të rregullave dhe rregulloreve të përcaktuara me procedurat përkatëse të AAC-së.” Rrjedhimisht, gjordat do të vendosen vetëm në rast të shkeljes së qëllimshme, të vazhdueshme ose neglizhencës serioze.*

33. 3. Ne fund ne konsiderojme që për çfarëdo papërgjegjësie të KTA-ve, përgjegjës për këtë gjë duhet të jete se pari OSHNA, përmes komisioneve disiplinore të saj dhe krejt në fund gjyq dhe asesi AAC, pasi që ne mendojmë që AAC nuk i ka kapacitetet për të luajtur rolin e gjyqit. Ne përgjigjet e kolegeve evropian, nuk kemi hasur praktike ku AAC merr rolin e gjyqit.

33. *Nuk pranohet.  
E drejta për shqyrtimin e gjorbave administrative derivon nga LAC përkatësisht nga nenet 96, 97 dhe 98 të LAC. Për më shumë EASA ka kërkuar që të kemi një rregullore e cila i implementon kërkesat e ligjit në nenet e lartcekura.*

34. Krejt në fund, duke u bazuar në atë çka u cek me lartë, ne e kundërshtojmë venien e gjorbave për personat fizik dhe përgjegjës, në vecanti pikën 18 të shtojcës për gjordat. Për t’i ikur keqkuptimit, ne nuk i kundërshtojmë gjordat për persona tjere fizik që bien ndesh me rregullat e aviacionit civil. Ne mendojmë që AAC, si nënshkruese e shume marrveshjeve të aviacionit civil në nivel evropian, do i respektojë kërkesat tona.

Nese për çfarëdo arsye nuk mirren parasysh kërkesat tona, ne ju paralajmërojmë që do marrim masa shtese për kundërshtimin e kesaj rregulloreje, përmes aktivizimit të ATCEUC-se në kete teme, rrjedhimisht Komisionit Evropian.

34. *Në lidhje me pikën 18 të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, AAC largon pikën 18.6, e cila është e mbuluar me pikën 10.1, të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje e cila e trajton këtë problematikë për të gjithë personelin e aviacionit civil. Kësaj pike do t’i shtohet edhe gjorda për persona juridik dhe personin përgjegjës.*

*Gjithashtu, do të fshihet edhe pika 18.4 pasi që është vërejtur se ajo trajtohet me ligjet tjera relevante.*

### III. Dërguar nga Bahri Nuredini, Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dt. 05.12.2018

35. Sa i përket përmbajtjes së rregullores, janë disa çështje ndaj të cilave ne si ASHNA kemi rezervat tona dhe që konsiderojmë që do të duhej të merreshin parasysh nga ju në përpilim të

versionit përfundimtar të rregullores mbi gjobat administrative. Pikat në vijim janë me interes për ASHNA-në dhe për to kërkojmë vemendjen tuaj të çmuar:

1. Në ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ka një Titull (Kapitull) të veçantë në lidhje me gjobat administrative, përkatësisht Titulli IV mbi Dispozitat Ndëshkimore, me nenet 96, 97, 98 për gjobat administrative për Ndërrhyrje, Gjobat Administrative për Shkeljet Tjera, përkatësisht Gjobat Administrative, Konsiderata, Konflikti Administrativ. Ne si ASHNA konsiderojmë që rregullorja e propozuar nga ju mbi Gjobat Administrative duhet të përfshihet në plotësim ndryshimin e ligjit në fjalë, apo me ndryshimin e ligjit në të ardhmen të largohen dispozitat në lidhje me Gjobat Administrative dhe të njëjtat të jenë të tëra në rregulloren e ardhshme për gjobat administrative;
35. *E drejta për shqiptimin e gjobave administrative nga AAC derivon nga LAC përkatësisht nga nenet 96, 97 dhe 98 të LAC. Për me shumë EASA ka kërkuar që të kemi një rregullore e cila i implementon kërkesat e ligjit në nenet e lartcekura.*
36. 2.ASHNA është e vetëdijshme që Kosova si rrjedhje e trashëgimit të marrëveshjes ECAA dhe nënshkrimit të marrëveshjes së MSA-së me BE-në ka obligimin që të përafrojë legjislacionin e saj me atë të BE-së. Në këtë drejtim edhe legjislacioni sekondar duhet t'i shërbejë këtij zotimi, rrjedhimisht ne dëshirojmë të dijmë se me cilën rregullore të BE-së përafrohet legjislacioni ynë, apo thënë ndryshe cilën rregullore të BE-së mëton ta transponojë kjo projekt-rregullore mbi Gjobat Administrative?
36. *Kjo rregullore derivon nga LAC dhe nuk ka për qëllim të transponojë ndonjë rregullore të BE-së.*
37. Në projekt-rregulloren për Gjoba Administrative vërehet se ka mungesë të dyshkallshmerisë në trajtimin e gjobave, është parim i përgjithshëm që të gjitha proceset duhet të kenë të pakten dyshkallshmeri. Sa për referencë, shih Ligjin për procedurë administrative <https://bit.ly/2raXxH2> ka kapituj të vecante për ankesën (neni 125, 136), kundërshtimin e vendimit të marre, që duhet të shqyrtohen nga organi epror. Poashtu, në një rregullore të qeverisë së Kosovës në lidhje me gjobat mandatore <https://bit.ly/2Rr2A1I>, në nenin 18 parashihet menyra e kundërshtimit të gjobes. Në këtë rast, në rregulloren e propozuar nga ju ceket si në vijim:

12.2 Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm për gjobën administrative është akt administrativ përfundimtar dhe kundër tij në procedurën administrative ankesa nuk është e lejuar.

12.3 Kundër këtij vendimi administrativ të AAC-së, ankesa nuk lejohet, por mund të iniciohet konflikti administrativ në gjykatën kompetente administrative të Republikës së Kosovës. Konflikti administrative mund të fillohet për çfarëdo arsye që e konsideron pala, me kusht që të zbatohen dispozitat e ligjit që e rregullojnë konfliktin administrative

Ne si ASHNA konsiderojmë që përmes projekt-rregullores mbi gjobat administrative, do të duhej të parashihej edhe dyshkallshmëria në lidhje me Gjobat Administrative, pra të lejohej kundërshtimi dhe ankesa dhe të njëjtat të trajtohen në nivel të procedurës administrative.

37. *Nuk pranohet.*

*Neni 125 i Ligji për procedurën e përgjithshme administrative thotë që përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrahet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative. Duke marrë parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm të AACK-së të përcaktuara me LAC, vendimet e tij për gjobën administrative janë përfundimtare por palët e pakënaqura me këto vendime mund të inicohet konflikti administrativ në gjykatën kompetente administrative. Ligji për konfliktet administrative specifikon që një konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit ankimi nuk është i lejuar.*

38. Ne projekt-rregulloren mbi Gjobat Administrative të propozuar nga Ju, ka disa referenca ndaj KFOR. Në Kushtetutën e Kosovës në nenin 153 flitet për Praninë Ndërkombëtare Ushtarake dhe në asnjë moment nuk ceket shkurtesa KFOR. Vec tjerash, pse duhet te ceket roli i KFOR-it apo i pranise nderkombetare ushtarake ne kete rregullore?

38. *Pranohet.*

*KFOR do të zëvendësohet me Prania Ndërkombëtare Ushtarake.*

39. Ne si ASHNA konsiderojmë që tavan i sipërm i gjobave administrative të parapara për OSHNA (ASHNA) do të duhej zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme. Në BE, sipas rregullores nr. 646/2012 (<https://bit.ly/2KRKuTQ>) në nenin 13 të saj ceket që shumica e gjithmbarshme e gjobave nuk mund të tejkalojë 4% të qarkullimit vjetor gjatë vitit paraprak. Nëse mbetet kufinjte e propozuar nga ju, atëherë konsiderojmë që ky tavan prej 4% mund të tejkalohej lehtësisht përmes shqiptimit të gjobave nga AACK.

39. *Nuk pranohet.*

*Rregullorja 646/2012 është e aplikueshme për gjobat që lëshohen nga Komisioni Evropian, si dhe tavan i prej 4% është i aplikueshëm për secilën gjobe individuale, dhe jo në vlerën e gjithmbarshme të gjobave. Për më tepër, neni 9, paragrafi 9.2.3 i draft-rregullores përcakton që gjatë shqyrtimit të shkeljes dhe vendosjes së gjobës, të merret parasysh edhe aftësia për pagesë dhe ndikimi i gjobës në aftësinë për vazhdimin e zhvillimit të veprimtarisë, duke garantuar kështu që vlera e gjobës të jetë brenda kornizave të arsyeshme.*

40. Ne si ASHNA konsiderojmë që duhet te shihet mundësia te largohen dispozitat ku cekën denimet ndaj personave fizik, duke qene se bie ndesh me politiken e “just culture”, koncept i cekur në disa dispozita në Rregulloren tjetër të AACK-së me nr 09-2017 mbi Raportimin, analizën, dhe përcjelljen e ndodhive në Aviacionin Civil, përveç rasteve kur veprimet e personave fizikë nuk mbulohen nga parimi i “just culture” (kulture të drejtë).

40. *Nuk pranohet.*

*Neni i lartcekur thotë:*

*“Where following the decision-making provided for in Section 2, the Commission finds that the certificate holder has intentionally or negligently breached Regulation (EC) No 216/2008 or its implementing rules, it may adopt a decision imposing a fine not exceeding 4 % of the annual income or turnover of the certificate holder in the preceding business year.”*

*Neni 4 i draft rregullores përcakton që “Procedura për shqyrtimin e shkeljeve administrative nga AAC fillojnë pasi që janë bërë përpjekje paraprake që në mënyrë të arsyeshme të respektohen mekanizmat në kuadër të procesit të zbatimit të rregullave dhe rregulloreve të*

*përcaktuara me procedurat përkatëse të AAC-së.” Rrjedhimisht, gjobat do të vendosen vetëm në rast të shkeljes së qëllimshme, të vazhdueshme ose neglizhencës serioze, dhe nuk bie ndesh me “just culture”.*

41. Në ASHNA kemi hasur në vështirësi në kuptimin e dispozitave të projekt rregullore në versionin shqip, shpesh-herë vetëm versioni në anglisht ka kuptimin që dispozita mëton të përçojë. Sa për ilustrim krahaso dispozitatat e nenit 16.1, 16.2 e të ngjashme në të dy gjuhët.

41. *Pranohet.*  
*Neni 16.1 dhe 16.2 në gjuhën shqipe do të përmirësohen duke zëvendësuar fjalën sigurim me ofrim.*

42. Neni 18.6 i projekt rregullore mbi Gjobat Administrative parasheh gjoba për mbajtësit e licencës së KTA-së nëse mos i ushtrojnë privilegjet e licencës nëse janë nën ndikimin e substancës ose medikamentit psiko-aktiv. Në si ASHNA konsiderojmë që kjo dispozitë nuk do të duhej të vrente vetëm për mbajtësit e licencave të KTA-së, por për gjithë personelin e përfshirë në shërbime operative.

42. *Pranohet.*  
*AAC largon pikën 18.6, e cila është e mbuluar me pikën 10.1, të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje e cila e trajton këtë problematikë për të gjithë personelin e aviacionit civil. Pikë 10.1 do t'i shtohet edhe gjoba për persona juridik dhe personin përgjegjës.*

#### **IV Dërguar nga Ardall Celina - Sekretar i përgjithshëm, Federatës Aeronautike të Kosovës më dt. 05.12.2018**

- 43 Duke patur parasysh realitetin ekonomik, ambientin kompleks e të jashtëzakonshëm për operime rekreative e sportive aeronautike në vendin tonë, në vlerësojmë se aeronautika rekreative dhe sportive edhe ashtu është shumë e cunuar dhe në disavatazh në krahasim me rajonin tonë dhe botën në përgjithësi. Prandaj përmes këtij komenti i propozojmë AAC-se që të pezulloj (largoj nga kjo propozim rregullore) gjobat që iu dedikohen pilotëve të fluturakeve të lehta (Paragllajd, Deltaplan dhe të ngjajshme) që merren me fluturime të lira dhe aktivitete rekreative e sportive. Kjo të pakten deri në momentin kur adresohen në mënyrë adekuate qeshtëjt e listuara më poshtë.

#### **ARSYETIM**

Kryesia e Federatës Aeronautike të Kosovës është e bindur që në këtë moment nuk mund të rregullohet aktiviteti aeronautik rekreativ e sportiv me gjoba financiare, e sidomos jo me shumë aq të larta që nuk përkojnë me realitetin ekonomik të pilotëve rekreativ e sportiv.

Pilotet rekreativ e sportiv në Kosovë operojnë në baza vullnetare, pa asnjë perkrashje financiare dhe gjithashtu në një ambient të papershtatshëm, prandaj në jemi të bindur që ata veqse janë të demtuar dhe aktivitetet e tyre veqse janë mjaft të cunuar. Arsyet kryesore për këtë bindje tonen janë keto:

1. Pilotet të fluturakeve të lehta që merren me fluturime të lira dhe aktivitete rekreative e sportive janë të obliguar të aplikojnë për leje fluturimi dhe atë jo më pak se 72 orë para kohës së planifikuar të fluturimit!

Ne te shumten e rasteve ndryshimet e vogla meteorologjike brenda 72 oreve pamundesojne realizimin e fluturimit te planifikuar (ngase kemi te bejme me fluturake te lehta dhe tejet te ndjeshem ne kushtet meteorologjike). Ne rajon dhe me gjere nuk aplikohen rregulla te tilla per keto fluturake!

44. 2. Pilotet te fluturakeve te lehta qe merren me fluturime te lira dhe aktivitete rekreative e sportive nuk kan zona dhe hapësira ajrore te definuara ku mund te realizojne fluturimet e tyre pa marr apo aplikuar per leje fluturimi! Ne rajon dhe me gjere jane te definuara vetem hapësirat ajrore ku pilotet nuk mund te zhvillojne aktivitetet e tyre ajrore dhe pastaj cdo hapësire jashte ketyre hapësirave te ndaluara eshte hapësire e fluturueshme dhe nuk kerkon pajisje me leje fluturimi. Leja per fluturim me keto fluturake merret vetem ne rastet kur kalohet neper zonat e ndaluara!

Federata Aeronautike e Kosoves eshte jashtezakonisht mirenjohese ndaj AAC-se per perkrahjen e vazhdueshme dhe bashkepunimin e ngushte e te sinqerte mes organizatave tona. AAC ka qene dhe shpresojme te mbetet nder partneret tane kryesore dhe kontributoret kryesore ne zhvillimin e aviacionit rekreativo-sportive ne Kosove. Prandaj shpresojme qe komentet tona do te shqyretohen dhe do te merren parasysh para aprovimit te kesaj rregulloreje.

43. *Projekt rregullorja në fjalë ndjeke praktikat standarde te shteteve anëtare te BE dhe vendeve te rajonit lidhur me gjobat administrative te shqiptuara ndaj palëve te cilat bëjnë shkelje te dispozitave te akteve ligjore përkatëse te fushës se tyre. Është me rëndësi te përmendet këtu fakti që këto gjoba pasojnë si masë e fundit ndaj personave fizikë dhe juridikë pasi të gjitha masat tjera adekuate janë shterur. Andaj ky propozim nga ana e FAK për përjashtimin e aktiviteteve rekreative dhe sportive nga kjo projekt rregullore nuk mund të pranohet. Megjithatë AAC-ja do te rishikoj shumen e gjobës për mundësi të zvogëlimit të saj në një nivel të arsyeshëm për këtë lloj të operimeve.*

1. *Është plotësisht e qartë dhe e kuptueshme shqetësimi i FAK-ut fakti qe aktivitetet rekreative dhe sportive janë të obliguar të aplikojnë për leje fluturimi dhe atë jo më pak se 72 orë para kohës së planifikuar tw fluturimit! Për fat te keq ky kushtëzim është kërkesë e KFOR-it e që AAC-ja bene përprjekje të vazhdueshme për lehtësimin e këtij kufizimi, mirëpo për momentin kjo mbetet ne fuqi.*

44. 2. *Sa i përket zonave dhe hapësirave ajrore te definuara ku pilotët e fluturakeve të lehta që merren me fluturime të lira dhe aktivitete rekreative dhe sportive mund te realizojnë fluturimet e tyre, siç është praktika në vendet e rajonit dhe me gjerë, një kërkesë e tillë duhet të vij nga ana e vet FAK-ut ashtu siç është diskutuar në shumë mbledhje të përbashkëta dhe bazuar ne kërkesën e FAK-ut AAC-ja do të bëj të pamundurën për aprovimin e tyre në bashkëveprim me autoritetet civile dhe ushtarake ne vend.*

### 13 PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloren, janë vlerësuar gjithsejt 44 vërejtje/komente me shkrim të cilat janë pranuar nga data 29 tetor deri



me 05 dhjetor 2018. Nga këto vërejtje/komente, AAC-ja ka pranuar pjesërisht apo tërësisht njëmbëdhjetë (11) vërejtje për adaptim/përmirësim të tekstit të rregullores të cilat do të inkorporohen në verzionin përfundimta të projekt-rregullores. Të gjitha komentet tjera kanë marrë përgjigjet adekuate.

**Raporti është hartuar nga:**

Departamenti i Aerodromeve  
Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror  
Departamenti i për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit  
Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve  
Zyra për Çështje Ligjore të Aviacionit